

UNIVERSITETI “A. XHUVANI” I ELBASANIT NE RRJEDHEN E ZHVILLIMEVE EUROPIANE TE ARSIMIT TE LARTE

Universiteti “A.Xhuvani” Elbasan aktualisht shenon zhvillime sasiore dhe cilesore drejt zhvillimeve dhe standarteve europiane .

Sistemi i vetvlerësimit e akreditimit modern është një nga prioritetet themelore të Universitetit, i cili përcakton efikasitetin, pozicionin, vendin midis universiteteve shqiptare e europiane.

Për këtë është përgatitur infrastruktura e domosdoshme brenda Universitetit per kete proces te rendesishem ne bashkepunim me partneret shqiptare dhe europiane .

Ndërkoh arritja e një pikësnyimi të tillë është parë në fokusin e rikonceptimeve e ndryshimeve të planeve, programeve mësimore për t'i përqsasur ato më shumë me nivelet europiane, pra po fillon te behet ajo që quhet vetëvlerësim që praktikisht ka filluar.

Në këtë kuadër duhen organizuar takime për të njohur principet e sistemit të vlerësimit e akreditimit të diplomave që përmbledh Sistemi i Pikëve të Kreditit për të gjitha degët, por dhe më tej për punën dhe ekuivalentimin e diplomave. Për këtë duhet te punohet për të gjetur modelet e përafërta të vendeve europiane.

- Në këtë drejtim ,çdo Fakultet te paraqite të plotë vizionin për zhvillimin e degëve dhe specialiteteve të tyre duke kaluar në diskutim të gjerë në procesin e vetëvlerësimit deri në atë të vlerësimit institucional e akreditues . Pra, përpunimi i një strategjie afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të çdo Fakulteti dhe të Universitetit mbi bazën e një orientimi të qartë mbi të ardhmen duhet te jete prioriteti i punës tonë.
- Ndërkaq, zhvillimi i kurrikulave të reja dhe pasurimim i atyre ekzistuese mbi bazën e politikës së zhvillimit të Arsimit të Lartë duhet te jete prioritet i strukturave të Universitetit.

Në këtë kontekst hallkë themelore duhet konsideruar përgatitja e dokumentacionit për e SHPU-së per mësuesine me standarte e parametra europiane si dhe te punohet që në të ardhmen UE të ketë të drejtë mbrojtje doktrature në degët e mësuesisë që mbulon.

- Riorganizimi dhe institucionalizimi i sistemit të kualifikimit pasuniversitar te mesueseve duhet paraprirë me hartimin e kurrikulave dhe programeve pasuniversitare me standarte

- bashkëkohore, duke e konsideruar atë si hallkë e sistemit të Arsimit të Lartë.

Ndërkoh riorganizimi strukturor i Universitetit për të rritur efikasitetin e çdo strukture është një prioritet tjetër. Për këtë është synuar të rritet roli i Universitetit si qendër e fuqishme shkencore nëpërmjet *integritit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor*, zgjerimit të pjesëmarrjes në projekte kombëtare europiane të kërkimit si dhe fuqizimi e kompletimin i bazës Laboratorike e shkencore.

Përmes një angazhimi të tillë synohet që Universiteti të jetë qendër e zhvillimit rajonal, organizimit të Konferencave Kombëtare e Ndërkombëtare, ku të zërë fill gjenerimi i ideve që çojnë përpara shoqërinë demokratike dhe intergrimin në familjen europiane.

Është e natyrshme se realizimi i objektivave të tillë shkon paralel me arritjen e një drejtimi administrativ efektiv. Në fokusin e këtij drejtimi përfshihen të gjitha nivelet si: Dega mësimore, Dega e Marrëdhënieve me jashtë, Dega e Financës, Dega e Informacionit dhe Statistikës, Sektori i Personelit, Sektori i Botimeve etj.

Në këtë aspekt janë qartësuar detyrat e secilit sektor, kompetencat dhe varësitë në marrëdhëniet hierarkike. Kjo shërben për të kuptuar dhe vlerësuar punën e gjithësecilit në sektorin administrativ dhe ekonomik, duke krijuar parametra dhe matësa të punës të çdo sektori.

Duke funksionuar kështu çdo hallkë e këtij sistemi evidentohet qartë puna e gjithësecilit që ndikon drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e punës mësimore, kërkimore-shkencore të stafit akademik të Universitetit etj.

- Ndërkoh krijimi i rrjetit informatik dhe informatizimi që është kryer për tërë sistemin e drejtimit administrativ në Universitet mundëson më së miri eficientësinë e tij.

Ndërkaq një nga prioritetet duhet të jete, krijimi i premisave të favorshme për punë të pavarur të studentëve. Këtij synimi do të shërbejë krijimi i Qendrës së Informimit Studentor e Internetit ku studentët të kenë mundësi lidhjeje e komunikimi brenda dhe jashtë vendit për të bërë një jetë aktive në të gjitha dimensionet, si dhe për të qenë në koherencë të plotë me literaturën bashkëkohore dhe Universitete europiane. Në këtë linjë ka ecur procesi i rregullimit, sistemimit dhe informatizimit të Bibliotekës ku ajo radhitet në bibliotekat me të mira universitare të vendit. Prioritet është ngritja e Qendrës së Botimeve Universitare që së bashku me sektorin e botimeve do të realizojnë mundësinë e pajisjes me literaturë e materiale të shtypura, libra e botime shkencore.

- Bashkëpunimi me elementë të shoqërisë civile dhe biznesit është një tjetër prioritet i UE. Krijimi i Qendres së Orjentimit

dhe Koperimit Universitet – Ndermarje prane Shkencave Ekonomike si dhe funksionimi i saj ka krijuar kete lidhje e bashkepunim.

- Hapa të rëndësishëm në këtë aspekt janë hedhur në forcimin e zgjerimin e qendrës së medias si dhe me ngritjen e Qendrës së Mesimit dhe Kualifikimit ne në Distancë si nje strukture qe do te zvendesoje gradualisht sistemin e korespodences dhe futjen e teknologjive bashkekohore ne procesin e mesmdhenjes . Marrja e fizionomisë institucionale e kësaj të fundit përmes legalizimit zyrtar nga MASH, krijon mundësinë që tashmë sistemi i edukimit në distancë të fitojë statusin e homologut të tij european.

Konform zhvillimeve bashkëkohore është konsideruar si prioritare krijimi i strukturave të reja universitare dhe jouniversitare. Në këtë kontekst është operuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe zhvillimet institucionale te natyrshme te Universitetit.

Kështu u miratuan nga MASH -i modalitetet për çeljen e strukturave të tilla:

- Shkolla e Lartë e infermierisë
- Dega e financë-kontabilitet me dy profile
- Dega e gjuhës italiane
- Qendra e Edukimit ne Distance
- Qendra e koperimit Universitet –Ndermarje
- Qendra e kerkimit Shkencor dhe Lab. i Provave dhe Analizave i akredituar.
- Dega e Gazetarise
- Dega e Punonjesit Social
- Dega e Filozofise dhe Sociologjise
- Dega e Psikologjise
- Dega e Edukimit Qytetar
- Departamenti i Psikologjise dhe Sociologjise
- Departamenti i Edukimit Qytetar dhe Gazetarise

Hartimi i modaliteteve për çeljen e këtyra strukturave është bërë konform standarteve e në kooperim me homologët european si dhe në përputhje me natyrën e universitetit tonë.

Lidhja e marveshjeve te bashkepunimit me Universitete Europiane si ai i Vjenes ne Austri, Fredonias SHBA , Barit Itali, Veliko – Turnoves Bullgari etj dhe pjesemarja ne projekte te perbashketa me ta, ka ritur rolin e

Universitetit dhe ka beri qe ai te jete qendra e zhvillimeve nderuniversitare ne nismat e Adriatik – Jonit dhe Koridorit 8..

Pra si përfundim mund të themi se rritja e punës mësimore, e punës kërkimore shkencore dhe parametrave matës të tyre , kualifikimi pasuniversitar i pedagogëve, përcaktimi i politikave të zhvillimit në kuadrin e autonomisë universitare, vetëvlerësimi dhe vlerësimi institucional akreditus i universitetit, rritja dhe thellimi i lidhjeve institucionale analoge me jashtë në nivel rajonal dhe europjan , konsolidimi i strukturave të reja akademike , përbëjnë prioritetet e punës në te ardhmen ne Universitetin “A. Xhuvani” Elbasan.

REKTORI

Prof. Dr. Jani DODE